




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS

Presednik Opštine – Municipal Mayor

LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

NGA DATA 11.12.2023 DERI MË 15.12.2023

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jofinanciare, kapitale dhe jokapitale	NRP-02-3631-2023
2.	Vendim për caktimin e ekipit për monitorimin e implementimit të projekteve të përfutësve të mbështetjes financiare	NRP-02-3634-2023
3.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve	NRP-02-3635-2023
4.	Vendim për ndërrimin e pozicioneve në kontratë	NRP-02-3638-2023
5.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3639-2023
6.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-3640-2023
7.	Vendim për caktimin e komisionit për zgjedhjen e punëtorit të vitit 2023 në administratën komunale	NRP-02-3642-2023
8.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3643-2023
9.	Vendim për caktimin e komisionit për zgjedhjen e fermerit të dalluar për vitin 2023	NRP-02-3646-2023
10.	Vendim për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, punimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2024	NRP-02-3647-2023
11.	Vendim për ndërrimin (kolaudimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”	NRP-02-3649-2023
12.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve	NRP-02-3650-2023
13.	Vendim për caktimin e Grupit Punues për procesin e parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative	NRP-02-3651-2023
14.	Vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e sportistit për vitin 2023	NRP-02-3652-2023



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Preşednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Nr./Br./No. 3631 / Nr. i faq./Br.str./No.pg. 67
Data/Datum/Date 11/12/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 2, nenit 18 dhe nenit 19 të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 5 të Rregullores së Komunës së Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe inventari i papërdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.3.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jofinanciare, kapitale dhe jokapitale

- Caktohet** komisioni për inventarizimin e pasurive jofinanciare, kapitale dhe jokapitale në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Tefik Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Admirim Durguti, anëtar,
 - 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar,
 - 1.4. Luan Sharku, anëtar,
 - 1.5. Sylejman Kadiri, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë inventarizimin e pasurive jofinanciare, kapitale dhe jokapitale të Komunës së Rahovecit, duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregulloren e Komunës së Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jofinanciare dhe inventari i papërdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22, të datës 30.3.2022.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 31.12.2023.
- Mandati i komisionit për inventarizimin e pasurive jofinanciare dhe financiare është dy (2) - vjeçar.
- Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br.No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br.No 3634 Nr. i faq/Br.str/No.pg 67

Data/Datum/Date 11/12/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 23 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e ekipit për monitorimin e implementimit të projekteve të përfituesve të mbështetjes financiare

1. **Caktohet** ekipi për monitorimin e implementimit të projekteve të përfituesve të mbështetjes financiare, lidhur me zbatimin e projektit sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të mbështetjes financiare nga projekti ReLOaD2, në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Artan Asllani, kryesues,
 - 1.2. Qendresa Duraku, anëtare,
 - 1.3. Anita Smailović, anëtare,
 - 1.4. Kaltrina Salihu, anëtare,
 - 1.5. Vlora Elshani, anëtare.
2. Ekipi ka për detyrë që të monitorojë dhe të bëjë raport mbi implementimin dhe zbatimin e projekteve apo të programeve sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të mbështetjes financiare nga projekti ReLOaD2, në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit, duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Obligohet ekipi monitorues që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
4. Ekipi monitorues do të fillojë punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e kontratës së lidhur ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të mbështetjes financiare.
5. Ekipi monitorues do të hartojë raporte periodike me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e ekipit monitorues,
- Vlora Elshani, menaxhere e projektit ReLOaD2,
- Përfituesi i mbështetjes financiare,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVAC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3635 Nr. i faq./Br.str./No.pg 67
Data/Datum/Date 11.12.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”) dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve

Caktohet komisioni për vlerësimin e dëmit në serra, të shkaktuara nga erërat e fuqishme, sipas kërkesave: kërkesa me Nr. të Prot. 6384, 6388, 6387, e datës 7.12.2023, kërkesa me nr. të prot. 6361, e datës 5.12.2023 dhe kërkesës me nr. të prot. 6303, të datës 30.11.2023, në këtë përbërje:

- 1.1. Ilvi Durguti, kryesues,
- 1.2. Veton Mustafa, anëtar,
- 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar.

1. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmit në serra, të shkaktuara nga erërat e fuqishme, sipas kërkesës me nr. të prot. 6384, 6388, 6387, e datës: 7.12.2023, kërkesës me nr. të prot. 6361, e datës 5.12.2023 dhe kërkesës me nr. të prot. 6303, të datës 30.11.2023.
2. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi.
4. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZhR-së, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3638 Nr. i faq/Br.str/No.pg 67

Data/Datum/Date 13.12.23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kontratës me titull “Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë - faza përfundimtare” me Nr. të Prokurimit 623-22-9863-5-2-1, Kërkesës së menaxherit të kontratës, me Nr. Prot. 6457, të datës 13.12.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin e pozicioneve në kontratë

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë - faza përfundimtare”, me Nr. të Prokurimit 623-22-9863-5-2-1.
2. Ndërrimi i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicioni (8.2) në pozicionet e domosdoshme për realizim III (3.1.), III (3.2.), III (3.3.), III (3.4.), III (3.5.), III (3.6.), III (3.7.) dhe VI (6. 2.) .
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Njësia e Prokurimit, Menaxheri i Projektit dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 13.12.2023, kemi pranuar kërkesën nga menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i kontratës, për ndryshim të pozicioneve në kontratën me titull “Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë-faza përfundimtare” me Nr. të Prokurimit 623-22-9863-5-2-1.

Ndërrimi i pozicioneve në këtë kontratë do të bëhet nga pozicioni (8.2), në pozicionet e domosdoshme për realizim III (3.1.), III (3.2.), III (3.3.), III (3.4.), III (3.5.), III (3.6.), III (3.7.) dhe VI (6. 2.) , në shumën e përgjithshme prej 4,693.80€ (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre e tetëdhjetë cent). Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit dhe dikasteret e tjera, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur. Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Menaxherit të kontratës,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë,
- DUPMM-së,
- Njesisë së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3639 Nr. i faq./Br.str./No.pg 67
Data/Datum/Date 13 / 12 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61, paragrafi 61.15, i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, i datës 10.4.2019, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit”, me numër të kontratës 623-23-10697-2-2-1/C539, si në vijim:
 - 1.1. Z. Samir Hasku, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: përgjegjës për automjete zyrtare, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Z. Besnik Hoti, drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3640 Nr. i faq./Br.str./No.pg 67
Data/Datum/Date 13 / 12 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizim me preparate për luftimin e insektit Cikadia e hardhisë së rrushit - Ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-23-13062-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-068-1-2-1, të datës 13.12.2023, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Bekim Krasniqi, kryesues,
 - 1.2.** Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3.** Kosovare Gashi, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Furnizim me preparate për luftimin e insektit Cikadia e hardhisë së rrushit - Ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-23-13062-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-068-1-2-1, të datës 13.12.2023.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 4 i paragrafit 11 të Rregullores për Dhënien e Titujve të Nderit, Dekoratave dhe Çmimeve nga Komuna e Rahovecit me nr.327/01, të datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

Për caktimin e komisionit për zgjedhjen e punëtorit të vitit 2023 në administratën komunale

1. Caktohet komisioni për zgjedhjen e punëtorit të vitit 2023 në administratën komunale në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Lendrit Qeli, kryesues
 - 1.2. Fjolla Duraku, anëtare
 - 1.3. Skender Hamza, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e punëtorit të vitit 2023 në administratën komunale, të shpërndajë mirënjohje, të ndërmarë të gjitha veprimet organizative për mbarëvajtjen e ceremonisë për ndarjen e mirënjohjes për punëtorin e dalluar të vitit, të shpërndajë ftesat për individ dhe grupe të rëndësishme për pjesëmarrje në ceremoni.
3. Komisioni është i obliguar që të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorisë për Administratë mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e ceremonisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Administratë.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria për Administratë, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3643 Nr. i faq./Br.str/No.pg 68

Data/Datum/Date 14/12/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-92, nenit 61 të paragrafit 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik nr. A01, i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr.1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit”, me numër të kontratës 623-21-4146-5-1-1/C324, si në vijim:
 - 1.1. P.M.N. Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. z. Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/1679/22, i datës 09.3.2022.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i projektit,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Rregullores për Dhënien e Titujve të Nderit, Dekorativave dhe Çmimeve nga Komuna e Rahovecit nr.327/01, të datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

Për caktimin e komisionit për zgjedhjen e fermerit të dalluar për vitin 2023

1. Caktohet komisioni për zgjedhjen e fermerit të dalluar për vitin 2023 në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues;
 - 1.2. Veton Mustafa, anëtar;
 - 1.3. Hasan Vuçitërna, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e fermerit të dalluar për vitin 2023, të shpërndajë mirënjohje, të ndërrmarë të gjitha veprimet organizative për mbarëvajtjen e ceremonisë për ndarjen e mirënjohjes për fermerin e dalluar të vitit 2023, të shpërndajë ftesat për individ dhe grupe të rëndësishme për pjesëmarrje në ceremoni.
3. Komisioni është i obliguar që të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe DBPZHR-në mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e ceremonisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DBPZHR, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNITETI I RAHOVCIT / ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3647 Nr. i faq./Br.str/No.pg 68

Data/Datum/Date 15 / 12 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2024

1. Me këtë vendim **Emërohen** personat zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2024, në këtë përbërje:

1.1 Zyrtar/e Autorizues/se për listën e pagave:

- Afrim Limani- kryesor
- Besnik Hoti- zëvendës

1.2 Zyrtar/e Autorizues për paga në Shëndetësi:

- Saranda Sallteku – kryesor
- Elbunit Kryeziu – zëvendës

1.3 Zyrtar/e Autorizues për paga në Arsim:

- Avni Morina – kryesor
- Saranda Sallteku – zëvendëse

1.4 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve:

- Perparim Krasniqi – kryesor
- Berat Duraku – zëvendës

1.5 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Shëndetësi:

- Saranda Sallteku – kryesor
- Elbunit Kryeziu – zëvendës

1.6 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Arsim:

- Avni Morina – kryesor
- Jeton Krasniqi – zëvendës

1.7 Zyrtar Autorizues për urdhërblerja - proces order:

- Astrit Mullabazi – kryesor

1.8 Zyrtar/e Zotues:

- Ardian Rama - kryesor
- Njomëza Fazliu – zëvendës

1.9 Zyrtar/e Certifikues:

- Esat Hoti - kryesor
- Ardian Rama - zëvendës

1.10 Zyrtar/e i Nënaloqimeve për Arsim:

- Lulzim Krasniqi – kryesore
- Bjondina Ramaj – zëvendëse

1.11 Zyrtar/e i Shpenzimeve:

- Zyber Thaqi - kryesor
- Egzon Thaqi - zëvendës

1.12 Zyrtar/e i Pranimeve:

- Qëndresë Kryeziu Hoxha - kryesore

1.13 Zyrtar/e autorizues të shpenzimeve për arsim (shkollat);

- Drejtorat e shkollave - kryesor
- Avni Morina - zëvendës
- Jeton Krasniqi - zëvendës

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Zyrtarët e emëruar,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyra e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3649 Nr. i faq./Br.str/No.pg 68

Data/Datum/Date 15 / 12 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me Nr. të Prokurimit 623-21-4434-5-2-1/C294, Kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 6489 e datës 15.12.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”

1. Me këtë vendim **lejohe**t ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me Nr. të Prokurimit 623-21-4434-5-2-1/C294.
2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet e kontratës: TABELA A – Varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Rahovec - Pozicioni 2.5, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A - Varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Rahovec – Pozicioni 1.3; TABELA - C – Pozicioni 1.3, 2.8 dhe 2.9; TABELA - D – Pozicioni 1.2, 1.10 dhe 1.12; TABELA - E – Pozicioni 3.5; TABELA – F – Pozicioni 2.5 dhe 4.1, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me Nr. të Prokurimit 623-21-4434-5-2-1/C294, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës me kërkesën e datës 20.11.2023 ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës, përmes Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 6489 e datës 15.12.2023, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zytari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me Nr. të Prokurimit 623-21-4434-5-2-1/C294 dhe atë nga pozicionet e kontratës: TABELA A – Varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Rahovec - Pozicioni 2.5,

në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A - Varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Rahovec – Pozicioni 1.3; TABELA - C – Pozicioni 1.3, 2.8 dhe 2.9; TABELA - D – Pozicioni 1.2, 1.10 dhe 1.12; TABELA - E – Pozicioni 3.5; TABELA – F – Pozicioni 2.5 dhe 4.1, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- ***Menaxheri i Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3650 Nr. i faq./Br.str./No.pg 68

Data/Datum/Date 15.12.23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me Nr. Prot.6428 të datës 8.12.2023, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

- Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të biznesve që mirren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore-Trangullit, sipas thirrjes publike për aplikim për "Furnizim me fidane dhe material tjetër të nevojshëm për kultimin e trangullit "Kornishan" me Nr. Prot.6428 të datës 8.12.2023, në këtë përbërje:
 - Hasan Vuqitërna, kryesues
 - Pajtim Haxhijaha, anëtar
 - Nazmi Bellaqa, anëtar nga Shoqëria Civile
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të bizneseve që mirren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore-Trangullit sipas thirrjes publike për aplikim "Furnizim me fidane dhe material tjetër të nevojshëm për kultimin e trangullit "Kornishan" me Nr. Prot.6428 të datës 8.12.2023.
- Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3654 Nr. i faq./Br.str/No.pg 69

Data/Datum/Date 15/12/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Programit për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative 2022 – 2027, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për procesin e parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative

1. **Caktohet** Grupi Punues për përgatitjen e procesit të parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Bjondina Ramaj – Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, kryesuese
 - 1.2 Fadil Bugari – Drejtoria për Shërbime Publike, anëtar
 - 1.3 Vlora Nazifi Gashi – Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtare
 - 1.4 Admirim Durguti – Drejtoria për Arsim, anëtar
 - 1.5 Valon Hoti – Drejtoria për Inspektim, anëtar
 - 1.6 Dritan Sokoli – Drejtoria për Administratë, anëtar
 - 1.7 Hasan Vuqitërna – Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Ruraë, anëtar
 - 1.8 Pajtim Haxhijaha – Drejtoria për Buxhet dhe Finaca, anëtar
 - 1.9 Fidan Hoti – Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar
 - 1.10 Muharem Morina – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
 - 1.11 Ardian Rama – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
2. Grupi punues ka për detyrë që të bëjë: Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda Komunës së Rahovecit, Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës dhe Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në Programin për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative 2022 – 2027.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Kushtrim Canolli, Zyra e Kryeministrit, dhe
- Arkivit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3652 Nr. i faq./Br.str./No.pg 69

Data/Datum/Date 15 / 12 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 4 paragrafi 10 i Rregullores për Dhënien e Titujve të Nderit, Dekoratave dhe Çmimeve nga Komuna e Rahovecit me nr. 327 të dt. 31.05.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i dt. 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

V E N D I M

Formohet komisioni për përzgjedhjen e sportistit për vitin 2023

1. Caktohet komisioni në këtë përbërje:
 - 1.1 Qemajl Krasniqi, kryesues
 - 1.2 Senad Alirifa, anëtar
 - 1.3 Vlora Reshiti, anëtare
 - 1.4 Servete Kastrati, anëtare
 - 1.5 Shaip Shala, anëtar
 - 1.6 Taulant Haxhimustafa, anëtar
 - 1.7 Nadir Sulejmani, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e sportistit të vitit në komunën e Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Komisioni do të filloj punën menjëherë dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

U dërgohet :

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Arkivi

